VENDIM
Nr.552, datë 7.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1164, DATË 25.11.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË QENDRËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4 e vendimit nr.1164, datë 25.11.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Kuota e pranimit në këto programe studimi të doktoratës, për vitin 2009-2010, është 77 dhe ndahet, si më poshtë vijon:

a) Në "Shkencat gjuhësore" 15 kuota;
b) Në "Studime letrare" 20 kuota;
c) Në "Shkencat etnologjike dhe folklor" 10 kuota;
ç) Në "Shkencat historike" 22 kuota;
d) Në "Shkencat arkeologjike" 10 kuota.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Qendra e Studimeve Albanologjike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha